



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

Në këtë buletin do të gjeni:

Takimi mbi sfidat për mbrojtjen e ajrit në Europë

Verifikimi në terren për ndalimin e qeseve plastike mbajtëse

Faqe 1

Aktivitetet e inspektimit mjedisor

Orët e edukimit mjedisor me nxënësit

Faqe 3

Përfaqësimi i AKM në Bordin Menaxhues të Agjencisë Europiane të Mjedisit

Raporti mbi Cilësinë e Ujërave Sipërfaqësore

Faqe 2

Vizita e Delegacionit të Agjencisë Europiane të Mjedisit në Shqipëri

Aktiviteti “Green Holidays”

Faqe 4

Takimi i 9-të i Palëve të Protokollit të Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR)

Faqe 5

Pjesëmarrje në programin ITP320/5 2021 “Zhvillimi i Strategjive për Menaxhimin Kombëtar

Faqe 6

Takimi mbi sfidat për mbrojtjen e ajrit në Europë

Ministria e Mjedisit e Republikës Çeke në kuadër të Presidencës Çeke në Këshillin e Bashkimit Evropian organizoi një seminar shumëvendësh TAIEX-EIR mbi cilësinë e ajrit për të diskutuar sfidat e ardhshme në mbrojtjen e ajrit në Evropë.

Synimi i konferencës është të inicojë një diskutim të nivelit të lartë dhe ekspertizë lidhur me mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit dhe gjithashtu të identifikojë pengesat e mbetura që po pengojnë progresin.



Duke pasur parasysh se cilësia e ajrit në BE ndikohet ndjeshëm nga ndotja e ajrit ndërkufitar, në diskutim janë ftuar të marrin pjesë edhe disa përfaqësues nga vende jashtë territorit të BE-së.

Në këtë takim mori pjesë edhe Drejtoresha e Përgjithshme e AKM-së Znj. Arta Dollani sëbashku me Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë Europiane të Mjedisit Z. Hans Bruyninckx, Drejtoreshën e Departamentit të Shëndetit Publik në Organizatën Botërore të Shëndetësisë Znj. Maria Neira nga DG Environment e shumë ekspertë kombëtar e lokal.



Verifikimi në terren për ndalimin e qeseve plastike mbajtëse

Referuar VKM-së Nr. 367, datë 30.05.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”, pika 8.1. “Për zbatimin e këtij vendimi krijohet Task-Forca për qeset plastike mbajtëse”.

Përbërja, mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, si dhe në zbatim të kërkesave të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 190, datë 15.11.2022 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimin të Task – Forcës për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme dhe oxo-biodegradueshme” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi:

Nga momenti i krijimit të Task – Forcës të përbërë nga inspektorë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut, Drejtorisë së Doganave dhe Policisë së Shtetit janë kryer verifikime dhe kontrole në terren në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fuqi për sa i përket përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse.



Nga kontrollet e kryera në njësitë e paracaktuara është sekuestruar një sasi qesesh, të cilat nuk plotësojnë kriteret në përputhje me ndryshimet ligjore në fuqi, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Vendndodhja	Numri i operatorëve të kontrolluar	Sasia e qeseve te sekuestruara
1	NJËSIA 1	35	5 Kg
2	NJËSIA 2	20	
3	NJËSIA3	25	2 Kg
4	NJËSIA 4	32	3 Kg
5	NJËSIA 6	45	10 Kg
6	SUPERMARKETE	10	
7	TOTAL	167 Operator	20 Kg

Për konstatimet e bëra nga ana e grupeve të punës, për gjetjet dhe shkeljet e kërkesave ligjore, janë marrë masa administrative si dhe janë sensibilizuar në zbatimin e saktë të legjislacionit.


Përfaqësimi i AKM në Bordin Menaxhues të Agjencisë Europiane të Mjedisit

Në takimin e 97-të të Bordit Menaxhues të Agjencisë Europiane të Mjedisit, ku Shqipëria, AKM kishte radhën e përfaqësimit për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Takimi u mbajt në 8 Dhjetor 2022, ku u diskutuan çështje të ndryshme dhe vendimarrje të rëndësishme, në linjë me kontekstin politik evropian.

Mesazhi i takimit: ‘Të gjithë vendet anëtare dhe jo anëtare të BE/EEA sot më shumë se kurrë gjenden përpara sfidave të mëdha politike, të cilat përherë e më shumë po ndikojnë në përshpejtimin e ritmit të transformimeve radikale dhe gjetjen e zgjidhjeve “by thinking out of the box”. E kjo veçanërisht në fushën e zbatimit të politikave mjedisore evropiane dhe në mënyrë të veçantë në implementimin e Agjendës së Gjelbër Evropiane (European Green Deal) nga të gjithë vendet, përfshirë bllokun e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Disa nga çështjet kryesore të takimit ishin:

- ✚ Procesi i implementimit të Agjendës së Gjelbër Evropiane
- ✚ Strategjia e EEA&EIONET dhe aktivitetet në zbatim të saj
- ✚ Zgjedhja e Kryetarit të ri të Bordit Menaxhues të EEA/Presidenca Suedeze
- ✚ Përditësimet strategjiko-programore dhe teknike nga Këshilli i Europës
- ✚ Projeksionet e Joint Research Center, KE
- ✚ Programi i Komitetit Shkencor dhe Bordit Këshillues të EEA
- ✚ Risitë e “Raportit të Gjendjes në Mjedis, Europa 2025”
- ✚ Miratimi i “Paketa Zero Ndotje ” i EEA&JRC etj.



Raporti mbi Cilësinë e Ujërave Sipërfaqësore

Burimet ujore janë jetike për njerëzit si një burim potencial për ujë të pijshëm po ashtu dhe në kuadrin e zhvillimit të sektorëve ekonomik të vendit.

Ne kemi detyrimin t'i menaxhojmë në mënyrën e duhur dhe të ruajmë vlerat e tyre duke i mbrojtur nga ndikimet negative. Për të arritur këtë, është e domosdoshme të kryhet monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së ujit si dhe identifikimin e shkaktarëve të ndotjes për mbrojtjen e mjedisit si dhe menaxhimin e duhur të ujërave.

Vlerësimi i cilësisë të ujërave tregon lidhjet shkak-pasojë të veprimit njerëzor dhe natyror në mjedis. Gjithashtu inkurajon të gjithë palët e interesuara që vazhdimisht të pyesin nëse po bëhet mjaftueshëm në:

- Zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të aktivitetit njerëzor (biznese, individë, komunitete, industri etj) dhe natyror (ngrohja globale, klima, erozioni etj)
- Ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së ujërave
- Zhvillimin e masave të përshtatshme për të vlerësuar dhe minimizuar presionet në mjedis

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka përgatitur raportin “Cilësia e ujërave sipërfaqësore në vendin tonë për vitin 2021”, i cili paraqet:

- Gjendjen e cilësisë të ujërave të lumenjve dhe liqeneve dhe tendencën në vite
- Aktivitetet që zhvillohen në zonat përreth pikave të monitorimit të lumenjve
- Forcat shtytëse, presionet, ndikimi
- Kuadri ligjor dhe strategjitë
- Rekomandime për përmirësimin e gjendjes

Synimi i vlerësimit të paraqitur në këtë dokument, është jo vetëm njohja me gjendjen e ujërave në lumenj dhe liqene, por edhe t'u japë politikëbërësve dhe palëve të tjera të interesit rekomandime se si të menaxhojnë më mirë mjedisin dhe të zhvillojnë politika për uljen e ndikimeve negative në cilësinë e ujërave sipërfaqësore.



Këtë dokument mund ta gjeni në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit www.akm.gov.al në rubrikën cilësia e mjedisit/raportime dhe publikime

Aktivitetet e inspektimit mjedisor

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, lidhur me procesin e inspektimeve në mjedis, ka kryer aktivitetet në lidhje me:

- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese.
- Zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve që shfrytëzojnë burimet natyrore, në mënyrë të vecantë guroret, minierat dhe subjektet me aktivitet shfrytëzimi të naftës dhe gazit
- Sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm në fuqi.
- Sigurimin dhe përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit.
- Parandalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të pa trajtuara në burimet ujore pritëse, sidomos gjatë sezonit turistik.
- Sigurimi i informimit për publikun për çështjet mjedisore.
- Sigurimi i informimit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit.
- Kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur.

Për sa i përket inspektimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit Mjedisor dhe Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore, për periudhën Shtator – Dhjetor janë kryer 217 inspektime, nga të cilat janë proceduar me masë administrative (gjobë) 34 subjekte.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, AKM në kuadër të Memorandumit të bashkëpunimit me AZHBR-në, me Nr. 2701 Prot. datë: 24.10.2017 dhe Nr. 2549 Prot. datë: 20.10.2017, ka lëshuar Çertifikatë të impaktit në mjedis, të cilat janë pjesë e dokumentacionit të nevojshëm për plotësimin e dosjes, për aplikantët në AZHBR, në kuadër të Implementimit të Programit IPARD II 2014-2020.

Për këtë arsye, Sektori i Inspektimit në Mjedis ka verifikuar në terren me procedurë të përsheptuar, rastet ku projektet kanë qënë në fushën e agroturizmit, bujqësisë dhe blegtorisë.

Këto investime janë pjesë e nismave të qeverisë shqiptare në kuadër të zhvillimit rural dhe prioriteti që i jepet zhvillimit të kësaj dege të ekonomisë.

Prioritet i aktiviteteve kanë qënë dhe ankesat e ardhura nga qytetarët nëpërmjet portalit të Bashkëqeverisjes dhe atyre në rrugë zyrtare pranë AKM. Gjatë periudhës Shtator - Dhjetor, Sektori i Inspektimit Mjedisor ka shqyrtuar dhe dhënë zgjidhje të gjitha ankesave sipas rasteve në një numër total prej 17 ankesave.

Orët e edukimit mjedisor me nxënësit


Aktivitetet ndërgjegjësuere të organizuara nga AKM në shkolla 9-vjeçare për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit kanë vijuar përgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2022. Menaxhimi i mbetjeve është mjaft i domosdoshëm dhe një nga pikat kyçe për mbrojtjen e mjedisit.



Me nxënësit e shkollave janë zhvilluar aktivitete edukuese ku theksi kryesor është mësimi i ndikimit të tyre në ambientin ku ata mësojnë, rriten dhe jetojnë.



Të mbash pastër mjedisin dhe ta ruash atë është detyrë e çdo qytetari!



Vizita e Delegacionit të Agjencisë Europiane të Mjedisit në Shqipëri

Ne kuader të bashkepunimit disa vjeçar të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Agjencinë Europiane të Mjedisit (EEA) dhe permbushjes së detyrimeve raportuese të Shqipërisë drejt këtij institucioni europian, në datat nga 21-23 Nëntor 2022 vizitoi Shqipërinë një Delegacion i nivelit të lartë të EEA i cili zhvilloi një seri takimesh maratone me përfaqësues të lartë politikëberës, drejtues institucionesh kombëtare të përfshirë në aktivitetet e EEA si dhe eksperte tematike kombëtare të nominuar në rrjet si përfaqësues zyrtarë.

Vizita e Delegacionit të EEA në Shqipëri ishte në vijim të disa takimeve të mëparshme ndërkombëtare të Ministres së Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Mirela Kumbaro me përfaqësues të lartë të saj dhe çështjeve të iniciuara në lidhje me forcimin e bashkepunimit dy palësh dhe ngritjen e performancës së Shqipërisë, në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe permbushjes së detyrimeve raportuese të vendit drejt EEA.



Për herë të parë në këto takime të nivelit të lartë, u artikulua mundësia e anëtarësimit të shpejtë të Shqipërisë në Agjencinë Europiane të Mjedisit, e cila është një çështje sa teknike aq edhe politike që kërkon angazhim të lartë dhe përkushtim në plotësimin e kriterëve të vendosura nga ana e institucioneve kombëtare. Intensifikimi i bashkepunimit mes paleve dhe ndarja e prioritetëve dhe objektivave strategjike mes tyre dhe qasja që institucionet duhet të kenë në drejtim të permbushjes, ishte fokusi i takimit me përfaqësuesit më të lartë drejtues të institucioneve kombëtare të përfshirë në çështjet e menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit dhe kerkimit shkencor në vend.

Roli dhe angazhimi i tyre si partnerë zyrtarë të AKM dhe EEA, dhe përfshirja e tyre në rrjetin kombëtar të Eionet kërkon bashkepunim të ngushtë mes paleve dhe venien në funksion të resurseve të nevojshme nga ana e tyre.



Sigurimi i mbështetjes së aktoreve lokale, pjesë e rrjetit kombëtar të Eionet, në drejtim të mirë funksionimit të tij dhe

implementimit me sukses të gjithë aktiviteve të parashikuara në Programin e Punës së EEA për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2023-2025, ishte kryefjala e takimeve të zhvilluar të Delegacionit të EEA gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Shqipëri.

Një takim mjaft i rëndësishëm ishte dhe ai me Delegacionin të EEA dhe Delegacionin të BE në Tiranë, në të cilin u diskutua mbi nevojën e bashkepunimit dhe mbështetjes që institucionet Shqiptare të përfshira në zbatimin e planit të punës dhe aktivitetëve me EEA duhet të marrin nga institucionet dhe donatorët europianë e me gjere.

Gjithë aktoret kombëtare si në nivel politik ashtu edhe në nivel teknik u angazhuan seriozisht që do të ofronin gjithë suportin dhe resurset e nevojshme në funksion të rritjes së performancës së Shqipërisë në aktivitetin dhe axhendën e përbashkët me EEA dhe Shqipërisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si partner zyrtar i kesaj të fundit.

Aktiviteti “Green Holidays”

Viti u mbyll me aktivitetin më të dashur për fëmijët! Green Holidays ishte tema kryesore ku fëmijët përçuan urimet e vitit të ri nëpërmjet mesazheve “të gjelbra”. Agjencia Kombëtare e Mjedisit me [#GizAlbania](#) [#APR](#) në një aktivitet sa edukativ dhe argëtues, në bashkëpunim me fëmijët e qendrës BoArt, nxënësit e klasës së tretë “Kristaq Rama” zhvilluan aktivitetin me temë “Green Holidays”.

Fëmijët e talentuar krijuan zbukurime për festat e fundvitit me materiale totalisht të riciklueshme si dhe shkëmbyen kartolina me mesazhe për mbrojtjen e mjedisit. Vizatuan trasta prej cohe, për të rikujtuar edhe njëherë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, burimeve natyrore, riciklimit dhe parimin e R-ve.



Takimi i 9-të i Palëve të Protokollit të Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR).

Në datat 24 - 25 nëntor 2022 u mbajt në Gjenevë takimi i 9-të i Palëve të Protokollit të Regjistrave të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (PRTR), ku vendi ynë u përfaqësua nga pika fokale e protokollit të PRTR e cila është edhe nënkryetare e Byrosë. Gjatë këtij takimi rëndësi të veçantë i'u kushtua çështjeve mbi mekanizmat e koordinimit dhe sinergjitë si dhe promovimi global i Protokollit konkretisht:

Në lidhje me mekanizmat e koordinimit dhe sinergjitë u theksua:

- Roli i rëndësishëm i Grupit për promovimin e ndërgjegjësimit për PRTR-të, sinergjinë dhe koordinimi për këtë temë të rëndësishme në nivel global
- Informacioni i dhënë nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimi (OECD), Instituti i Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Kërkim (UNITAR), dhe Republika e Moldavisë duke folur në emër të Kryesuesit të Task Forcës për Qasjen në Informacion sipas Konventës së Aarhusit;
- Vlerësimi për folësit dhe organizatat e tjera partnere për mbështetjen e ofruar për të çuar më tej sinergjinë dhe zbatimin e sistemeve PRTR duke forcuar kështu kapacitetet e vendeve për të aderuar në Protokollin për PRTR-të;
- Thirrje ndaj organizatave partnere përkatëse dhe marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore (MEA) për të bashkëpunuar ngushtë aty ku është e mundur për të krijuar sinergji për të çuar më tej zbatimin e aktivitetet në lidhje me PRTR-të;



- Gjithashtu përsëriti thirrjen drejtuar palëve të interesuara që të konsiderojnë zbatimin e Protokollit dhe Sistemit të Përbashkët të Informacionit Mjedisor (SEIS) në sinergji.




- Përsëritja e thirrjes drejtuar qeverive për të forcuar bashkëpunimin midis ekspertëve që merren me Protokollin mbi PRTR-të dhe ato që kanë të bëjnë me Konventën për Akses në Informacion, Pjesëmarrje Publike në vendimmarrje dhe akses në drejtësi për çështjet mjedisore (Konventa Aarhus), Konventa për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me rreze të gjatë (CLRTAP), Konventa mbi Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale (Konventa për Aksidentet Industriale), Konventa për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare (Konventa e Ujit), UNEP/ Plani i Veprimit Mesdhetar (MAP) dhe Konventat e UNEP-it për Kimikatet (Konventat e Bazelit, Roterdamit dhe Stokholmit dhe Konventa e Minamatës mbi Mërkurin), Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe të tjera marrëveshje dhe programe përkatëse, si dhe të përfshirë në projekte të kryera nga organizatat ndërkombëtare për të siguruar koordinimin në nivel kombëtar;

Promovimi global i Protokollit:

- Mori parasysh informacionin e paraqitur nga UNEP, sekretariatet e Bazelit, Roterdamit dhe Konventat e Stokholmit dhe Konventa e Minamatës mbi Mërkurin, dhe shprehu vlerësim e saj për prezantuesit për ndarjen e përvojave të vlefshme;
- I kërkoi Byrosë me mbështetjen e sekretariatit të eksploronte mundësitë për bashkëpunim në të ardhmen me traktate dhe procese të tjera, duke përfshirë përgatitjen e analizës krahasuese të detyrimeve të ndryshme të raportimit ndërkombëtar në lidhje me anekset I, II dhe III të Protokollit për Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- U bëri thirrje palëve, shteteve dhe organizatave të tjera të interesuara që të vazhdojnë promovimin global të Protokollit, duke përfshirë edhe vënien në dispozicion të materialeve udhëzuese përkatëse në të gjitha gjuhët e Kombeve të Bashkuara;
- Përsëriti thirrjen drejtuar sekretariatit dhe shteteve të interesuara për të përkthyer tekstin e Protokollit në gjuhët e tjera zyrtare të Kombeve të Bashkuara;

- Përsëriti thirrjen ndaj Palëve, vendeve dhe organizatave të tjera të interesuara për të promovuar PRTR-të si një mjet raportimi për MEA-të që kanë të bëjnë me kimikatet dhe për MEA-të e tjera përkatëse;
- Inkurajoi në këtë drejtim pikat qendrore kombëtare të Protokollit të angazhohen me pikat qendrore kombëtare të instrumenteve të tjera përkatëse dhe të promovojnë bashkërisht përdorimin e PRTR-ve për raportimin mbi marrëveshjet dhe proceset ndërkombëtare, duke kujtuar në këtë kontekst Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm për konsumin dhe prodhimin e përgjegjshëm ; aktivitetet përkatëse të OECD-së; Protokollin për Mbroytjen e Detit Mesdhe nga ndotja nga burimet dhe aktivitetet me bazë tokësore (Protokollin LBS) në Konventën për Mbroytjen e Mjedisit Detar dhe Rajonit Bregdetar të Mesdheut (Konventa e Barcelonës) dhe Amendamenti i Protokollit LBS; dispozitat e lidhura me PRTR të Konventës së Stokholmit të vitit 2001 mbi Ndotësit Organikë të Përhershëm (POPs) dhe të Konventës së Minamata të 2013-ës mbi Mërkurin; dhe traktati i ardhshëm për t'i dhënë fund ndotjes plastike;



- Inkurajoi Palët e Protokollit të marrin në konsideratë promovimin e përfshirjes së dispozitave për PRTR-të edhe në traktatet përkatëse të ardhshme, duke përfshirë një instrument ligjor të detyrueshëm për ndotjen plastike, duke përfshirë mjedisin detar, duke nxitur sinergjinë dhe duke shmangur dyfishimin e punës.

Në kuadër të zhvillimit të protokollit u diskutua mbi dy tematika kyesore “Drejt sistemeve moderne të regjistrimit të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve” si dhe “Lidhjet e mundshme me ndotjen plastike dhe përpjekjet e lidhura me të”.

Grupi i Punës mori parasysh deklaratat e delegacioneve dhe miratoi rezultatet dhe vendimet kryesore që do përfshihen në raportin final.

Inkurajoi pikat qendrore kombëtare të Protokollit për të promovuar, në bashkëpunim me pikat qendrore kombëtare të traktateve dhe organizatave të tjera përkatëse, mbështetjen financiare, si nëpërmjet Fondit Global të Mjedisit (GEF), për vendet që dëshirojnë të krijojnë sisteme PRTR të tyre ose si grup.

Pjesëmarrje në programin ITP320/5 2021 “Zhvillimi i Strategjive për Menaxhimin Kombëtar

Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pjesëmarrëse në programin ITP 320/5 2021, u përfaqësua nga dy specialistë të Sektorit të Kimikateve, Zj.R.Anastasi dhe Zj.S.Spahiu në takimin dy javor organizuar në **Agjencinë Suedeze të Kimikateve**.

Agjencia në kete takim u prezantua në nivel kombëtar me projektin me titull: **Sharing information related chemicals at NEA’s website and performing the helpdesk task of chemical sector**.



Për finalizimin e këtij projekti nga sektori u punua për një periudhë një vjecare që nga muaji gusht 2021 kur u bë aplikimi për pjesëmarrje në program e deri në nëntor 2022 ku dhe u paraqiten rezultatet e arritura për periudhën një vjecare.

Gjatë këtyre dy javëve në Suedi përveç, prezantimit të projektit u zhvilluan disa trajnime të ndryshme në lidhje me kimikatet, pesticidet, ndryshimet klimaterike etj.

U kryen disa vizita të ndryshme, ku përmendim vizitën në një Agjenci Ushqimi tek e cila u kryen disa prezantime në lidhje me procedurat e kontrollit të cilësisë për pesticidet, analiza e mbetjeve në ushqim, SweEt si metodë alternative me shumë mbetje për analizën e pesticideve, vlerësimi i rrezikut të mbetjeve të pesticideve, metoda analitike për mbetjet e pesticideve në ushqim. vizitë në laboratorin e kimisë, etj.

Gjithashtu u zhvillua dhe një vizitë tek një rafineri naftë Nynasham tek e cila u kryen disa prezantime në lidhje me Klasifikimi & Etiketimi, fletët e të dhënave të sigurisë (SDS), inventarët kimikë dhe legjislacionet si REACH etj



